

INFORMACIONE



KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT KORRIK

2 Korrik 2004	Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH
2 Korrik 2004	KOKSH & AIPS (edicioni IV) Dita Ndërkombëtare Gazetarëve Sportivë
6-7 Korrik 2004	Konferenca Ndërkombëtare e CIO për Paqe Nikosia / Qipro
7 Korrik 2004	Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH
13 Korrik 2004	Lojrat Olimpikë në sytë e fëmijëve
13-14 Korrik	Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të COE z. Patrick Hickey në Tiranë
15 Korrik 2004	MKRS-KOKSH takim pune
28 Korrik 2004	KOKSH – GALA OLIMPIKE



KORRIK 2004

2 Korrik 2004

Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH

Në ambjentet e House of Arts në praninë e mediave u zhvillua mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH ku si rend dite për diskutim ishte: - *Lojrat Olimpike « Athina 2004 »*.

Nën drejtimin e z. Domi në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv. Ishin të ftuar Ministri i K.R.S z. Blendi Klosi, Drejtori i sportit cilësor në MKRS z. K.Llazani dhe përfaqësues nga Dhoma e Tregëtisë.



U bisedua edhe për mardhëniet ndër-institucionale dhe projekteve të ndryshme të KOKSH. Një falenderim të veçantë Presidenti bëri për Ministrin e Turizmit për botimin e broshurës turistike me rastin e Lojrave Olimpike « Athina 2004 ».

2 Korrik 2004 KOKSH & AIPS

Dita Ndërkombëtare e Gazetarëve Sportivë (edicioni IV)

Tashmë është edicioni i katërt që KOKSH në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve Sportivë Shqiptarë, mbledh së bashku gazetarë sportivë nga të gjithë mediat e vendit ato të shkruara dhe elektronike dhe feston « Ditën Ndërkombëtare të Gazetarëve Sportivë ». KOKSH me rastin e kësaj feste organizoi edhe ceremoninë e dhënies së Trofeut « Media dhe Sporti » i akorduar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (CIO) i cili iu dorëzua TV Telesport për promovimin e sportit dhe Lëvizjes Olimpikë. Gjithashtu në këtë festë iu dorëzua karta e akreditimit gazetarëve të cilët do të marrin pjesë në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 ».



6-7 Korrik 2004

Konferenca Ndërkombëtare e CIO / Qipro

« *Forumi Rajonal mbi Paqen dhe Sportin* »

Për dy ditë me rradhë në Nikosia të Qipros u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare e CIO. Konferenca kishte në fokusin e saj: « *Sporti si mjet që gjeneron paqe* ». Në këtë Konferencë morën pjesë Presidenti i KOKSH z.H.Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z.S.Bello, i cili bëri dhe një prezantim të punës që KOKSH ka bërë gjatë këtyre viteve lidhur me temën në fjalë.

7 Korrik 2004

Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH

Në ambjentet e KOKSH u zhvillua mbledhja e Komisionit Teknik të KOKSH kryesuar nga z. Fidel Ylli, Kryetar i këtij Komisioni. Në mbledhje ishin prezent të gjithë anëtarët e Komisionit, gjithashtu kishte edhe të ftuar të tjerë nga federatat FSHP, FSHM, FSHA, FSHN, QKSH, dhe Bashkia Tiranë.

Objekt i diskutimit në këtë mbledhje ishin pikat e rendit të ditës:

1. *Lista përfundimtare e Delegacionit zyrtar për Lojrat olimpikë « Athina 2004 »*
2. *Diskutime mbi specifikat e projekteve të KOKSH – Talentet e Reja.*

13 Korrik 2004

Lojrat Olimpikë në sytë e fëmijëve

Me mbështetje të plotë të KOKSH, përpara Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës u organizua ekspozita e pikturës « Lojrat Olimpikë në sytë e fëmijëve Shqiptarë ». 20 fëmijë të moshës 6-10 vjeç pikturuan dhe hodhën në fletët e vizatimit mendimet dhe idetë e tyre rreth Lojrave Olimpikë.

Këtë ekspozitë gjeti rastin ta vizitojë Sekretari i Përgjithshëm i COE z. Patrick Hickey i shoqëruar nga Presidenti i KOKSH z. Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello.



KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Informacion Mujor – Korrik 2004



13-14 Korrik 2004

**Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të COE
z. Patrick Hickey në Tiranë.**

Me një ftesë të bërë nga KOKSH, Sekretari i Përgjithshëm i COE z. Patrick Hickey bëri një vizitë 24 orëshe në Shqipëri.

Si pjesë e axhendës së tij tepër të ngjeshur e rëndësishme për tu përmendur është takimi Protokollar në MKRS ku u prit nga zv. Ministri Dragoti dhe një mbledhje pune e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH gjatë së cilës Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello prezantoi raportin e punës 1 vjeçare të KOKSH për vitin 2003 dhe objektivat për 2004.

z. Hickey theksoi se « Është vërtet e admirueshme puna e vazhdueshme dhe vizioni që KOKSH dhe autoritetet e tij shfaqin në përbushjen e strategjisë dhe misionit të Lëvizjes Olimpike... »



Në përfundim të vizitës së z. Hickey, në ambientet e KOKSH u zhvillua një konferencë për shtyp.

15 Korrik 2004 MKRS - KOKSH takim pune

Ministri i KRS z.Klosi priti në një takim pune Presidentin e KOKSH z.Domi, Sekretarin e Përgjithshëm z. Bello dhe një pjesë të delegacionit Olimpik të cilët do të marrin pjesë në Lojrat Olimpike « Athina 2004 ». Ndër të tjera në këtë takim u zhvillua edhe ceremonia e akordimit të fondit për Ekipin Olimpik Kombëtar Shqiptar sipas një projekti të bërë nga KOKSH.



**15 Korrik 2004 KOKSH-Amb.Gjermane-FSHF
Ekzpozita « Planet Futboll »**

Në bashkëpunim me Ambasadën Gjermane, Institutin Gotte dega e Selanikut, KOKSH, FSHF dhe Galeria e Arteve u bë e mundur organizimi i Ekspozitës « Planet Futboll ». Ambasadori Gjerman, Presidenti i KOKSH dhe zv. Presidenti i FSHF përshëndetën me fjalën e rastit çeljen e kësaj ekspozite. Presidenti i KOKSH z.Domi citoi se : « Njëpërmjet të tilla ekspozitave ne do ti krijojmë mundësi publikut të gjerë e në veçanti brezit të ri që në mënyrë shumë artistike dhe intelektuale të demonstrojmë vizionin dhe misionin që Lëvizja Olimpik dhe Sporti kërkon ti japin shoqërisë në përgjithësi dhe brezit të ri në veçanti ». Ekspozita ishte e ndarë në 2 Panele

- Paneli për Planetin e Futbollit
- Paneli Olimpik (Komiteti Olimpik Gjerman dhe Komiteti Olimpik Shqiptar)

Në fund ekspozita u mbyll me një lojë « gjuajtje nga penalltia ».

28 Korrik 2004 KOKSH – GALA OLIMPIKE

Me rastin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 », KOKSH organizoi Mbrëmjen Gala në Pallatin e Brigadave për nder të sportistëve dhe Delegacionit Olimpik që do të përfaqësojnë Shqipërinë. Për të përshëndetur Delegacionin Olimpik ishin të ftuar autoritetet më të larta të Shtetit, fushës së Sportit, përfaqësues të trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë, mediat, etj.

Fjala përshëndetëse nga Presidenti i KOKSH z. Domi çeli këtë Mbrëmje Gala në nder të Delegacionit Olimpik. Pas ekzekutimit të Himnit Kombëtar Shqiptar Zv. Kryeministri Namik Dokle dorëzoi në mënyrë ceremoniale, Flamurin Shqiptar Sportistes Olimpikë e cila do ta mbajë atë gjatë Ceremonisë së Hapjes së Lojrave Olimpikë. Gjithashtu Ministri i K.R.S. z. Klosi uroi Sportistët dhe Delegacionin Olimpik për një përfaqësim dinjitoz të Shqipërisë në këto Lojra. Më pas Mbrëmja u shoqërua nga darka Koktejl dhe muzikë dhome.

